

**Deklarata e PSSP-së Caroline Ziadeh për Këshillin e Sigurimit të OKB-së
8 prill 2025**

Monsieur le Président, Excellences,

Distingués membres du Conseil de sécurité, mesdames et messieurs, Je tiens a feliciter la France pour sa Presidence du conseil de securite pour le mois d'Avril.

1. C'est un honneur pour moi de présenter au Conseil les derniers développements survenus au Kosovo depuis la publication du rapport du Secrétaire général, qui couvre la période du 16 Septembre 2024 au 15 mars de cette année, et de partager avec vous quelques observations clés.

Monsieur le Président,

2. Duhet të theksohet se zgjedhjet e datës 9 shkurt ishin të qeta, edhe pse jo edhe pa ndërlikime teknike dhe ankesa nga partitë politike. Ishte veçanërisht inkurajuese të shihen rritjet në përfaqësimin e grave në Kuvendin e Kosovës, duke mos pasur nevojë të zbatohet kuota gjinore prej 30 për qind e paraparë në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme. Së këndejmi, dëshiroj t'i përgëzoj qytetarët e Kosovës edhe për një palë zgjedhjet të tjera të qeta dhe gjithëpërfshirëse.
3. Pas certifikimit të rezultateve më datën 27 mars, pres formimin e shpejtë të qeverisë së ardhshme, duke ditur njëkohësisht se kjo mund të kërkon negociata komplekse. Pas themelimit të qeverisë, është nevojë imediate që të ndërmerren hapa konkretë në prioritetizimin e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës, si dhe në zbatimin e përkushtimeve të bëra në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja në mënyrë që të qohet përpara procesi i normalizimit të marrëdhënieve.
4. Pas emërimit në janar të z. Peter Sørensen si Përfaqësues i ri Special i BE-së për dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit, pres të kem bashkëpunim të ngushtë me të. Angazhimi i tij që në fillim jep mundësinë për përkrahje të të dyja palëve drejt përparimit. Arritjet e bëra në dhjetor, kur Beogradi dhe Prishtina u pajtuan për kushtet dhe kriteret e punës së Komisionit të përbashkët për persona të zhdukur, duhet të jenë frymëzim për të gjithë në ecjen përpara në fushat e dialogut.
5. Së këndejmi, dëshiroj t'i nxisë të gjitha palët që t'i shfrytëzojnë në plotëni të arriturat e këtij Komisioni të përbashkët dhe të Grupit punues për persona të zhdukur në mënyrë që të vazhdojnë punën pa vonesa të tjera dhe t'u ndihmojnë familjeve në zbardhjen e fatit të dashurve të tyre.
6. Brenda këtij konteksti, dëshiroj të përkujtoj vdekjen e z. Bajram Querkinaj, babait të djalit të zhdukur, i cili ia përkushtoj dekadat e jetës së tij të drejtës për të ditur fatin e personave të zhdukur dhe përpjekjet e të cilit kaluan përtej kufijve të komuniteteve dhe etnive, duke ngërthyer humanizmin e të gjithë të prekurve. Trashëgimia e tij vazhdon të jetë udhërrëfyes i këtyre përpjekjeve, me ç'rast UNMIK-u mbetet i përkushtuar në mbështetjen e Qendrës së Resurseve për Persona të Zhdukur dhe i të gjitha familjeve që ende kërkojnë përgjigje.

z. kryesues,

7. Kur vizitova veriun e Kosovës më 25 mars, bashkëbiseduesit e shoqërisë civile, udhëheqësit politikë dhe komuniteti theksuan një mungesë të vazhdueshme të besimit, veçanërisht ndaj institucioneve, duke ndarë shqetësimet për atë që i pret marrë parasysh kontekstin aktual politik dhe zhvillimet në rajon e më gjerë. Ata u ankuan për veprimet e njëanshme të ndërmarra nga autoritetet e Prishtinës, duke përfshirë mbylljen e fundit të qendrave të mirëqenies sociale të drejtuara nga Serbia dhe ndikimin negativ socio-ekonomik që kjo mbyllje ka pasur. Megjithatë, ata nuk panë alternativë për Dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja dhe nevojën që serbët e Kosovës të rimarrin ndjenjën e udhëheqjes përmes një sistemi të vetëmenaxhimit brenda asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Ata i bëjnë apel bashkësisë ndërkombëtare që të mbështes të gjitha përpjekjet për një angazhim të ripërtërirë me vullnet të mirë në kuadër të procesit të normalizimit. Bashkëbiseduesit prapë ngritën shqetësime rreth pretendimeve të mëparshme për ngacmime seksuale të grave serbe në publik. Të gjitha këto pretendime duhet të hetohen.
8. Gjithnjë kam shprehur shqetësimet e mia lidhur me mbylljen e institucioneve të drejtuara nga Serbia dhe pasojat e saj në të drejtat ekonomike e sociale, posaçërisht për personat në gjendje të cënueshme. UNMIK-u do të vazhdoj përcjelljen nga afër të këtyre ndikimeve. Po ashtu, rritet thirrja për përmbajtje nga veprimet e njëanshme dhe nxisë që çështjet e pazgjidhura të diskutohen në mënyrë konstruktive e me vullnet të mirë brenda dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja.

z. kryesues,

9. Vendimi i marrë së fundmi nga qeveria e Kosovës për t'ua mundësuar banorëve që kanë dokumente të lëshuara nga institucionet e drejtuara nga Serbia në Kosovë për të regjistruar dokumentet e gjendjes civile tek autoritetet përkatëse është i mirëseardhur. Ky është një element i rëndësishëm në eliminimin e sfidave të gjendjes civile të komuniteteve joshumicë, dhe në veçanti të qytetarëve serbë të Kosovës. Megjithatë, boshllëku ende mbetet lidhur me fushëveprimin, interpretimin dhe zbatimin e vendimit. Rrjedhimisht, inkurajoi një rritje të përpjekjeve informuese drejt komuniteteve të prekura dhe u bashkohem të tjerëve në përkrahje të vazhdimit të afatit aktual të 30 prillit.

z. kryesues,

10. E dënoj sulmin në kanalin Ibër-Lepenc që ndodhi më 29 nëntor dhe rritet thirrja për hetim gjithëpërfshirës dhe transparent për identifikimin e personave përgjegjës dhe kërkimin e llogarisë nga ata. Kërkoj nga të gjithë udhëheqësit që të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme, t'i shmangen përshkallëzimeve dhe të bashkëpunojnë në sjelljen para drejtësisë të fajtorëve.
11. Më shumë se një vit që nga ndodhja e incidentit të sigurisë në Banjskë, dua të nënvizoj rëndësinë e sigurimit të llogaridhënies përmes procedurave gjyqësore të drejta dhe të pavarura.
12. Ky rast dhe sulmi në kanalin Ibër-Lepenc, theksojnë nevojën për angazhim të efektshëm dhe aplikim të mekanizmave të ndihmesës së ndërsjellë juridike në mbështetje të hetimeve dhe ndjekjeve penale aktuale.

13. Për më tepër, dëshiroj të shpreh shqetësimet e mia rreth mjetit shpërthyes që është hedhur në zyrën e sapohapur të postës së Kosovës në Zveçan më datën 1 prill, me ç'rast u shkaktuan dëme materiale. Siç kam cekur edhe me herët, aktet e tilla të dhunës janë të papranueshme dhe duhet të hetohen plotësisht dhe me shpejtësi, ndërsa fajtorët duhet të sillen para drejtësisë.

z. kryesues,

14. Dua gjithashtu të nënvizoj rolin qendror të Inspektoratit Policor të Kosovës për sigurimin e hetimeve të pavarura lidhur me pretendimet e përdorimit të tepërt të forcës dhe keqtrajtimin nga policia në veri të Kosovës, duke përfshirë edhe të të miturve. Kërkoj që gjetjet të bëhen publike me qëllim të avancimit të transparencës dhe besimit në institucione. Derisa Inspektorati ka hapur një numër rastesh, përcjellja e tyre dhe masat disiplinore janë thelbësore në parandalimin e përsëritjes së këtyre rasteve. Në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, gjithashtu inkurajoj autoritetet që të veprojnë sipas rekomandimeve të cekura në Procedurat e posaçme të OKB-së, duke përfshirë edhe përdorimin më të madh të alternativave të mbajtjes në paraburgim.

z. kryesues,

15. Jam thellësisht e shqetësuar nga zhvillimet lidhur me shkatërrimin e simboleve fetare, ku ai i fundit ishte drejtuar kundër Kishës Ortodokse Serbe, të cilat shkojnë në kundërshtim me të drejtën për lirinë fetare dhe paraqesin rrezik për rritjen e tensioneve fetare e ndëretnike. Rrjedhimisht, kërkoj nga të gjithë që të respektojnë vendet fetare dhe të avancojnë tolerancën.
16. Gjithashtu dua të theksoj arrestimin e 16 individëve në Gjakovë dhe Prizren më 5 dhe 6 prill, derisa po bënin një vizitë fetare në Pejë. Derisa shumica e pelegrinëve janë liruar, katër janë ende në mbajtje për 30 ditë.
17. Në interes të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve, zbatimi i plotë i Ligjit për përdorimin e gjuhëve mbetet thelbësor. Dëshiroj të cek skadimin e mandatit të komisionerit për gjuhë më 25 janar 2025 dhe të rritjes së thirrjes së Sekretarit të Përgjithshëm për autoritetet e Kosovës që me shpejtësi t'i ndërmarrin masat për emërimin e komisionerit për gjuhë për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave gjuhësore dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë.

z. kryesues,

18. Ndërtimi i besimit mbetet kyç në krijimin e një të ardhme stabile dhe prosperuese për të gjitha komunitetet në Kosovë. Përkundër sfidave të vazhdueshme, të cilat pasqyrojnë një ndjenjë të mungesës së besimit në institucione dhe shqetësim për marrëdhëniet mes komuniteteve, UNMIK-u qëndron fuqishëm në përkushtimin e tij për tejkalimin e ndasive. Në thelb të përpjekjeve tona për ndërtimin e besimit qëndrojnë nismat për sundimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe avancimin aktiv të përfshirjes së grave dhe të rinjve në proceset e paqes. Brenda këtyre rrethanave, misioni ynë është i përkushtuar në mbështetjen e përpjekjeve në terren, përmes të cilave përkrahen të gjitha komunitet, në veçanti përmes aktiviteteve tona programatike që fokusohen në avancimin e dialogut ndëretnik dhe në kundërshtimin e konteksteve ndarëse me qëllim të trajtimit të mungesës së besimit.

19. Qendra Barabar e përkrahur nga UNMIK-u ka qenë nikoqire e mbi 100 ngjarjeve, ku kanë marrë pjesë mijëra pjesëmarrës, duke demonstruar kështu rolin e saj si një qendër për dialogun ndërtnik dhe hapësirë e sigurt për komunitetet që të angazhohen në biseda domethënëse drejt krijimit të një shoqërie më rezistuese dhe përfshirëse.
20. Shtatorin e kaluar, në kuadër të zotimit të UNMIK-ut për avancimin e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe integrimin e perspektivave gjinore në procesin e pajtimit, kisha nderin dhe privilegjin e pjesëmarrjes në një tryezë të rrumbullakët të nivelit të lartë në Tiranë. Kjo tryezë bashkoi përfaqësues të nivelit të lartë për avancimin e barazisë gjinore në procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës.
21. UNMIK-u do të vazhdojë punën me partnerët vendorë në fuqizimin e qasjes në drejtësi, në përkrahje të ndihmës juridike për të gjitha komunitetet dhe në digjitalizimin e arkivave gjyqësore. Po ashtu, në bashkëpunim me shoqërinë civile, UNMIK-u vazhdon në avancimin e të drejtave pronësore përmes aktiviteteve të shënjestruara në terren.
22. Puna me rininë mbetet në qendër të projekteve të Misionit për ndërtimin e besimit. Këto projekte synojnë avancimin e mirëkuptimit kulturor dhe të marrëdhënieve afatgjata për promovimin e paqes së qëndrueshme, posaçërisht kur marrim parasysh se kontaktet mes të rinjve të komuniteteve të ndryshme janë gjithnjë e më të pakta në krahasim me brezat e mëhershëm. Në këtë drejtim, një projekt që përfshinë vizita të përbashkëta të vendeve të trashëgimisë fetare e kulturore të njëri-tjetrit, me përfshirje gjithnjë e më të madhe të të rinjve nga komuniteti shqiptar, serb, boshnjak, rom, ashkali dhe turk po ndihmon në tejkalimin e mosbesimit në mesin e të rinjve. Njëkohësisht me këtë, një projekt inovativ për arsimimin STEM po hap horizonte të reja për vajzat në shkollat rurale me komunitete të ndryshme, duke shfrytëzuar laboratorë mobilë dhe klube dinamike të shkencës për tejkalimin e ndarjeve, nxitjen e kërshërisë dhe fuqizimin e shkencëtarë dhe udhëheqësve të brezit të ardhshëm.

z. kryesues,

23. Dëshiroj të shpreh falënderimin e tim për bashkëpunimin e ngushtë dhe përkrahjen që çdo e ditë e kemi me partnerët tonë shumëpalësh – në veçanti KFOR-i – dhe për fuqinë e bashkërendimit tonë me Ekipin e OKB-së në Kosovë. Së bashku, dhe me përkrahjen tuajn të vazhdueshme, ne do të ruajmë fokusin tonë në të drejtat dhe mirëqenien e njerëzve në Kosovë.
24. Ju apeloj të gjithë juve në këtë Këshill të respektuar që të mbesni të vendosur në përkrahjen tuaj për paqe, stabilitet dhe bashkëpunim parimor në Kosovë. Përmes përkushtimit të përbashkët, mund të ndihmojmë në fuqizimin e dialogut të besueshëm politik, në mbrojtjen e të drejtave themelore dhe në vënien e themeleve më të forta për siguri dhe përparim më të madh.

z. kryesues,

25. Dëshiroj të përfundoj duke ju shprehur falënderimet e mia më të thella juve, anëtarë të nderuar të Këshillit, për angazhimin tuaj të përhershëm me Misionin e UNMIK-ut. Vëmendja juaj e vazhdueshme mbetet thelbësoren në përpjekjet tona të përbashkëta.

Ju falënderoj z. kryesues.